



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2499/4 Prot.

Tiranë, më 14.08.2023

VENDIM

Nr. 51, datë 14.08.2023

PËR
“MIRATIMIN E TRAJTIMIT FINANCIAR TË KËSHILLIT TË ETIKËS TË
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; neni 44; në Statutin e UMT-së, nenet 32 dhe 37; në VKM nr. 329/2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”; në Rregulloren “Për funksionimin e Këshillit të Etikës në UMT”, neni 25; në shkresën nr. 1584 prot., datë 11.05.2023 të Kryetarit të Këshillit të Etikës, si dhe në Vendimin e Senatit të UMT-së nr. 76, datë 30.06.2023, për “Miratimin e trajtimit financiar të Këshillit të Etikës dhe Këshillit të Botimeve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, në mbledhjen e datës 14.08.2023, Bordi i Administrimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë trajtimin financiar për Këshillin e Etikës në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, si më poshtë:
 - a) në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë/muaj për kryetarin dhe secilin nga anëtarët;
 - b) numri maksimal i pagesave në një vit është 10 (dhjetë).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim Këshillit të Etikës dhe Administratorit të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFFERI

ENDRIT YZEIRAJ